

KULTURA POPULLORE SHQIPTARE NË PËRM- BLEDHJEN E UDHËPËRSHKRIMEVE

"PO ALBANIJI - DOJMOVI S PUTA"

("Nëpër Shqipëri - mbresa udhëtimi")

Në mesin e shkencëtarëve sllavë të Jugut, të cilët në fund të shekullit XIX dhe në fillim të atij XX kanë mbledhur, studiuar dhe botuar lëndë nga krijimtaria gojore dhe etnografike shqiptare, shquhet edhe Llavro Mihaçeviqi (Lovro Mihacevic), prifti kroat dhe mik i madh i Shqipërisë dhe i popullit shqiptar. Ai për katërmëdhjetë vjet shërbeu në Shqipëri (nga viti 1839 si mësues i të rinjve të urdhërit françeskan në Kuvendin e Troshanit, ku përveç gjuhës latine dhe italishte, jepte edhe gjuhë shqipe të cilën e mësoi për katër muaj; nga viti 1906 si provincial i provincës së re françeskane të Shqipërisë me seli në Shkodër), krahas disa shënimeve etnografike, historike, gjeografike dhe demografike, bëri udhëpërshkrime, mblodhi, i botoi dhe i studioi disa krijime popullore shqiptare. Ata i ilustroi me fotografi të veshjes popullore të meshkujve dhe të femrave të Jugut dhe të Veriut dhe me pejzazhe të qytetit, fshatit malit, lumit dhe luftëtarëve. Tekstet e tyre i përktheu edhe në gjuhën kroate. Si fryt i kësaj pune të zellshme janë sidomos librat e tija: "Po Albaniji"¹ dhe "Crtime iz albaneske povijesti" që e botoi në Sarajevë, si edhe e ditarit "Moji dozivljaji u Albaniji", nga i cili, fatkeqësisht janë ruajtur tetë faqe². Ai në Sarajevë botoi më 1908 veprën "Schematismum almae Provincil Missionarie Albaniae"³.

Në veprën "Po Albaniji ..." ai merret me letërsinë gojore. Lirikën popullore e shqyrton kryesisht në kaptinën e shënimeve etnografike "Zakonet e shqiptarëve". Duke qëmtuar zakonet e vdekjes tek shqiptarët, ai vështron ceremonialitetin e varrimit. Këto shënime çojnë peshë për historinë e folkloristikës dhe etno-

Albanologji

grafisë shqiptare. Por Ll. Mihaçeviqi lirikës më tepër i qaset kur flet për doket në Shkodër (f. 109-119). Përshkrimin e nis me doket e fejesës dhe të martesës.

Ll. Mihaçeviqi edhe letërsisë popullore shqiptare i kushtoi një kaptinë (f. 120-135). Iu qas edhe poezisë popullore lirike dhe këngëve të rasti (dasmore). Shton se nuk ka popull në Europë më pak të arsimuar se shqiptarët, por ky popull edhe në primitivizmin e vet ka shumë ndjenja fisnike mbi shpirtmadhësinë, mbi nderën, lavdinë, mbi krenarinë, mbi nderimin e të parëve, mbi bukurinë e grave, për çka këndohet në këngët popullore shqiptare, por edhe gjuha e tyre kryekëput është e përshkruar (gërshtuar) me poezi. Në mbledhjen e thesarit të tyre popullor janë marrë Reinhold, De Han, Pouqueville, Dozon, Mitko, Bosile, Hecuard, Camarda, Crispi, Staffa, Biondelli, Schire etj (f. 120). Më tutje thekson se këngët popullore të dashurisë ekzekutohen dhe këndohen sidomos në valle, që luhen më shumë në dasma. Më në fund është kënga popullore humoristike, me të cilën përqeshën ndonjë ngjarje qesharake apo e turpshme, ndonjë pabesi apo tradhëti.

Ai i ka botuar edhe 128 fjalë të urta sipas rendit alfabetik. Teksti i tyre në gjuhë shqipe përmban mjaft gabime gjuhësore. S'e ka njohur mirë alfabetin shqip. Në vend të shkronjës q shkruan c. Anën fonetike deri diku e ka ruajtur mirë (f. 12-135).

Përsa i përket epikës popullore shqiptare, ai, në radhë të parë, u interesua për baladën popullore shqiptare të themelimit të Shkodrës, "Zidanje Skadra na Bojani", siç e quan ai nën ndikimin e gjuhës së tij amtare. Nuk arriti ta mbledhë këtë baladë, por shënoi një motërzim të asaj legjende në prozë. Vë në pah se për këtë kështjellë shqiptarët flasin kështu: "Kanë qenë vëlla e motër në zë dhe të pasur. Ai quhej Rosa ndërsa ajo Fa. Rosa filloi të ndërtojë kështjellën, por atë që ndërtonin mjeshtrit ditën, natën iu rrënohej dhe ai u detyrua që ta ndalojë ndërtimin. Duke kërkuar përse ndodh kjo, ndesh në një plak, i cili i tha që në mur të murosë gruan të gjallë, dhe ndërtimi do të fillojë dhe gjithmonë të jetë me fat. Që atëherë i erdhi për vizitë vëllait të vet motra Fa dhe e bindi që të ndjekë ndërtimin. Por kur i tha i vëllai se çka i ka treguar plaku, ajo pranoi që atë ta vendosin, meqë ka pasur një fëmijë të vogël gjiri, e lut, që të mund nëpër birë të

Albanologji

murit, derisa të jetë gjallë, fëmijën e vet ta pajtojë. Ashtu ndodhi, prandaj edhe sot duket në mur të qytetit një vend tepër i bardhë si gjurmë e kësaj ngjarjeje (f. 66-67)".

Për dallim nga disa të ashtuquajtur shkencëtarë, të cilët në atë kohë kanë menduar se shqiptarët nuk kanë asnjë këngë popullore mbi themelimin e Shkodrës mbi Buen⁴, LL. Mihaçeviqi, me të drejtë cek se motivi mbi themelimin e këtij qyteti është ruajtur deri më sot edhe ndër shqiptarë (f. 67). Mendimin e tij, në kohë të fundit, e vërtetuan edhe dy punime magjistrature me këtë temë. Është dëshmuar se janë botuar katërmbëdhjetë motërzime.

Tetë prej tyre janë nga Kraja⁵.

Në pikëpamje metodologjike studiuesi Mihaçeviq e shtroi drejt problemin. Ai së pari u interesua për poezinë popullore legjendare, për t'iu qasur më vonë zhvillimit të epikës popullore historike. Siç dihet, e para (legjendarja) i paraprinë asaj të dytës. Zhvillimi i poezisë legjendare nga lashtësia e thellë përmban në vete traditën epike të shqiptarët. Ajo është shtrirë në gjerësi dhe në thellësi dhe drejtpërdrejt ka ndikuar më vonë në zhvillimin e vetë epikës historike. Ll. Mihaçeviq thotë: "Çfarë është shqiptari, ashtu është edhe poezia e tij. Në këngët e trimërisë këndohen veprat e trimërisë, gjakmarrja, mbrojtja e fesë, qëndresa kundër pushtetit (f. 121)".

Po ashtu e shënoi edhe një legjendë për Skënderbeun. Të dyja këto legjenda do ta kishin vlerën edhe më të madhe sikur t'i kishte shënuar edhe në shqip. Disa vargje të këngëve popullore lirike, rreth 128 fjalë të urta dhe një këngë popullore epike i shënoi edhe në gjuhën shqipe, por me shumë gabime. Përkthimin e tyre në kroatisht e bëri shumë më mirë. Është dashur që këto krijime t'i shënojë mirë në gjuhën shqipe, të japë të dhëna të plota për tregimtarët - këngëtarët, vendin në të cilin i shënoi etj.

Nuk mund të miratohet qëndrimi i tij se edhe kënga popullore kreshnike ka rëndësi lirike, meqë në ato këngë elementi lirik shpreh emocionin e cili gërshetohet në të treguarit epik.

Deri te mendimet sipërfaqësore mbi epikën popullore shqiptare autori erdhi nga shkaku se atë nuk e diti as nuk e studioi në mënyrë të thelluar. Teorinë e vet e zhvilloi në bazë të shqyrtimit të një kënge epike, të cilën e quan këngë trimërie (f. 121-122).

Motivi i këngës është kacafytja e përgjakshme ndërmjet Gjin Lekës dhe Adem Shemës.

Edhe pse dy personazhet janë shqiptarë, këngëtari popullor ushqen simpati ndaj Gjin Lekës. Adem Shemën e quan turk. Ademi dinakërisht e akuzoi Gjinin se i ka vjedhur qetë, ndërsa ky, duke konstatuar se nuk është fajtor, e vret Ademin. Kësaj fitoreje rapsodi popullor i jep tjetër kuptim. Kështu këngës i zvogëlohet rrëfimi poetik, bukuria, vlerat njehose, artistike dhe edukative. Kjo vërehet në vargjet 13, 19, 37-40 (f. 121-122). Teksti i këngës është i mbushur me gabime ortografike.

Ndonjëherë i shmanget zanores ë, duke ruajtur dy herë radhazi zanoren i, i. Në mes të fjalës bie edhe theksi: Shqiptariis (shqiptarisë) t'valiis (t' valisë). Në fjalët ku është ruajtur dhe theksuar zanorja, në vend të njërës përdor dy. Ky fenomen është me interes për fonetikën historike të gjuhës shqipe. Tani ajo mund të dëgjohet aty-këtu, në disa të folme popullore. Një shënim i tillë nuk praktikohet në lëndën e botuar të letërsisë gojore.

Bien në sy edhe mjaft gabime morfologjike. Mund të supozohet se këtë këngë, si edhe disa vargje lirike i shënoi pa kritere të forta shkencore. Ka mundur të gjejë këngë më të mira. Ai shërbeu në një trevë me traditë të pasur epike. Aty, shekuj me radhë dëgjohet dhe këndohet kënga në përcjellje të lahutës dhe çiftelisë. Madje këngën nuk ia këndoi këngëtari, por ia recitoi.

Këngën gjegjëse më 1911 e botoi Vinçenc Prennushi me 52 vargje. Me këtë rast ai i hoqi gabimet gjuhësore. As Prennushi nuk dha shënime të duhura, me përjashtim se theksoi se këngën e shënoi në Gomsiqe - Mirditë⁶. Më vonë atë këngë, por pa gabime, e botoi Kasem Taipi në përmbledhjen "Zana popullore - Kangë popullore", Shkodër 1933, f. 200-202. Prej V. Prennushit këngën e botoi edhe Qemal Haxhihasani në kuadrin e këngëve mbi ngjarje të ndryshme⁷. Prej tij këngën e mori Denush Shala dhe e radhiti në mesin e këngëve mbi ngjarje të ndryshme dhe trimëri⁸.

Dy botuesit e fundit e botuan motërzimin me 44 vargje. I hoqën vargjet me përmbajtje të paqëndrueshme. Në vargun e dytë, në vend të emrit të malit Le (Dukagjin, në jug të Karmës), e kanë shkruar përemrin vetor: ne. Ata nuk e kanë ruajtur as

Albanologji

formën fonetike as theksin e disa fjalëve të cilat i ka dhënë Ll. Mihaçeviqi: edhe; Shema; nën; hana; nana.

Është dashur Ll. Mihaçeviq që thellësisht ta studiojë epikën popullore shqiptare. Në bazë të analizës së shumë këngëve të jepte një gjykim më të drejtë. Nuk duhej të vinte te një qëndrim i gabuar se “epikën popullore në kuptimin e drejtë të fjalës shqiptarët s’e kanë (f. 120)”. Ll. Mihaçeviqi s’arriti ta arsyetojë as mendimin se këngëtari popullor shqiptar nuk e zhvilloi askund fillimin e ngjarjeve, ashtu siç ndodhi me këngët popullore kreshnike kroatoserbe. Shton se ai krejt është marrë me madhësinë e ngjarjeve ose famën e trimit, për të cilin këndon; edhe në këngë të veta i fut ngjarjet vetëm për të gjetur shprehje për madhësi dhe famë që vetëm e tërheqin dhe për të cilat dëshiron të këndojë. Këngëtari i përmend rrethanat kryesore, por atëherë më tepër e përshkruan përshtypjen, sesa rrjedhën e ngjarjeve; ai nuk këndon për aktin, por për famën e tij (f. 120). Studiuesi nuk i mori në shqyrtim vlerat ideoestetike, tematike, letrare-artistike dhe gjuhësore-stilistike të këngëve.

Në bazë të analizës së gjithanshme të këngëve popullore epike të cilat janë krijuar deri në fillim të këtij shekulli, kur edhe shkroi Ll. Mihaçeviq, del se kjo poezi e lashtë me shekuj ka jetuar në traditën gojore. Ajo gjithmonë ka qenë e lidhur me ngjarjet kombëtare historike. Në të këndohet për rezistencën e popullit kundër çdo shtypjeje. Këndohet për trimëritë e personazheve të vet, luftërat dhe përpjekjet e tyre në mbrojtje të atdheut nga Perandoria Osmane. Prandaj ata nuk këndojnë për gjakmarrje, siç thekson Ll. Mihaçeviq (f. 120). Përkundrazi, figurat e këtyre këngëve janë dhënë shumë drejt. Poetit popullor motivet i janë të njohura. Ai di çka do. Kurrë s’e shau armikun as nuk i nënçmoi aftësitë luftarake. Këngët i përmbajnë të gjitha momentet e zhvillimit të vet. Ato zhvillohen në hapsirën e caktuar gjeografike dhe kohore. Ç’është e vërteta, ngjarjet historike ndikojnë në zhvillimin e vetë epikës. Ndërkaq, epika historike shqiptare nuk ka pasur për qëllim që ato t’i përcjellë vetëm në mënyrë kronologjike, si ndonjë dokument plotësues, por ato t’i këndojnë dhe t’i gërshetojnë letrarisht dhe estetikisht. Me këtë rast vijnë në shprehje veçoritë stilistike dhe gjuhësore të vetë këngëve. Ato janë të pasura me figura të ndryshme stilistike.

Albanologji

Ll. Mihaçeviq thekson se kali, shpata dhe flamuri janë objektet kryesore me të cilat lidhet testamenti i trimave shqiptarë. I tillë është Dedi Skura, Pavo Guglielmo, Petar Shini (f. 123). Në të vërtetë, Pal dhe Llesh Dukagjini, Pal Golemi, Nik Peta. Dedë Skura dhe Pjetër Shini janë personazhe të poezisë popullore të arbëreshëve të Italisë, e cila lidhet me ciklin e këngëve për Skënderbeun dhe bashkëluftëtarët e tij.

Përndryshe, edhe Ll. Mihaçeviq në vështrimin e vet, me çdo kusht, më tepër ia ka kushtuar vëmendjen figurës së Skënderbeut në epikën popullore shqiptare. Është krejt dukuri e ligjshme që figura qëndrore e kësaj poezie të jetë ajo e Skënderbeut. Legjenda dhe historia për këtë trim, thotë më tej Mihaçeviq, janë të lidhura ngushtë mes veti dhe shton: "Flitet se si e ëma e tij Vojsava kur ishte me të me barrë, pa në ëndërr se mbart kuçedrën, që e ka mbuluar tërë Shqipërinë; bishti i lagej në det përballë venedikasve, ndërsa në grykë të ndezur ka përbri shumë osmanllinj. Me rastin e lindjes, thonë, se si në dorë të djathtë ka lënë gjurmë shenjën e shpatës. Gjëra të ngjashme fliten për të nga mosha e fëmijërisë. Përveç kësaj ka qënë edhe shumë i mënçur. Kur është rritur, forca e tij ka qënë si objekt rrëfenje. Në njëzet e dy luftëra me dorë të vet i ka prerë rreth 2.000 armiq. Veçanërisht legjenda e lavdëron për luftra me turqit (f. 124). Ll. Mihaçeviq vë në pah se të gjitha këngët e trimërisë mirren me të dhe e zmadhojnë, por shqiptari këndon edhe për disa trima tjerë të tij: për Radovanin, Milo Shinin etj. Krejt jeta e Skënderbeut është vetëm një këngë, ndaj edhe vdekja i është poetike. Me të ka jetuar populli, ka jetuar Shqipëria dhe me rastin e lajmit për vdekjen e tij, Dukagjini, vojvoda, me plot të drejtë i fton gratë fisnike dhe zotërinjtë, të varfërit dhe ushtarët që të qajnë, meqë, me këtë rast mbeten jetimë, pa babë, i cili i këshillonte dhe i ndihmonte; ai ishte krenari për vasha, lavdi për fqinj, baba dhe zotëri i Shqipërisë (f. 124).

Duke folur me shumë nderim për figurën e Skënderbeut, thotë se për të flet poezia e tyre popullore, melankolike dhe e dhembshme, e cila i kapet ngushtë me zemër duke kënduar për rrëmbimet, burgjet, persekutimet dhe vdekjet (f. 124).

Duke pasur parasysh kohën se kur e ka shkruar, mungesën e literaturës dhe studimin jo të mjaftueshëm të asaj poezie, ky

Albanologji

është një vështrim i mirë për shëmbëlltyrën e Skënderbeut. Por duhet theksuar se poezia popullore epike shqiptare ka filluar të zhvillohet shumë më herët. Kështu poezia popullore epike shqiptare lidhet me Luftën e Kosovës (1389). Dihet se shqiptarët janë në anën e aleatëve ballkanikë në luftë kundër ushtrisë osmane. Në këngët mbi luftën e Kosovës këndohet për trimërinë e Millosh Obiliqit (Millosh Kopiliqit).

Vështrimi i tij mbi poezinë popullore epike shqiptare i bërë mbi bazën e një këngë të vetme, madje të dorës së dytë, me motiv të hakmarrjes, është i mangët. Nuk arriti ta krahasojë këtë epikë as me atë të trevës gjuhësore kroatoserbe. Ai e përmend motivin e përbashkët të baladës për themelimin e Shkodrës. Mirëpo do theksuar se ky motiv ka karakter internacional. Si i tillë ai gjendet edhe te popujt tjerë të Ballkanit, dhe më gjërë, por edhe i brumosur me specifika të veta.

Në fund të librit autori dha një vështrim edhe mbi punën letrare në Shqipëri. Mori në spikamë shkrimtarët që nga Frang Bardhi e deri tek bashkëkohësit e tij, siç janë: Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Gaspër Jakova e të tjerë.

Mbi sa u shkrua, del se përkundër vërejtjeve që mund t'i bëhet këtij libri, ai ka vlera të mëdha shkencore dhe si i tillë është pritur mirë edhe nga kritika shqiptare⁹. Ai me të e pasuroi kulturën tonë popullore në radhë të parë. I dha disa materiale që nuk gjenden më në terren. I shprehu disa gjykime mjaft të mira. Qëllimi i tij ishte fisnik dhe dashamirës. Vepra bëri bujë sidomos në kohën kur u botua, meqë të tjerët, në ato momente të krijimit të shtetit shqiptar, çdo gjë po na mohonin.

1 Frau Lovro Mihaceviq, Po Albaniji (Dojmovi s puta), "Matica Hrvatska, Zagreb, 1911. Libri i ka 144 faqe dhe një hartë. Më tej, në kllapa do të japim vetëm faqen e tij.

2 Shih, Zekeriacana, Kontributi shkencor i Llovro Mihaçeviqit, "Përparimi", 7-8, Prishtinë 1964, f. 499.

3 Shih, Kahreman Ulqini, Zë i ri në enciklopedinë shqiptare. Kroati L. Mihaçeviq për Shqipërinë, në "Bashkimi", Organi Qëndror i Frontit Demokratik të Shqipërisë, Tiranë, e diel, 8 shtator 199 (?), f. 3, nr. 207 (13253), në rubrikën Shkencë, Kulturë.

4 Dr. Vladan Djordjeviç, Arnauti i veliko sile, Beograd, 1913.

Albanologji

- ⁵ Halit Tërnavci, Motivi i murimit në këngët popullore shqiptare. "Përparimi", 1, Prishtinë, 1968, f. 21-27; Ismail Doda, Balada krajane e murosjes së gruas (Punim magjistrature), Universiteti i Kosovës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 1984, f. 1-378, në f. 110, 111, 251-259 janë dhënë edhe motërzimet.
- ⁶ Këngë popullore gegnishte, mbledhë e rreshtue prej V. prenushit, Sarajevë, 1911. Cituar sipas Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912), III, Instituti i Folklorit, Tiranë 1962, kënga nr. 12, f. 290-291.
- ⁷ Këngë popullore historike, Instituti i Shkencave, Instituti i historisë dhe i Gjuhësisë, zgjedhur e pajisur me shënime nga Qamil Haxhihasani nën kujdesjen e Zihni Sakes, Tiranë 1956, kënga nr. 266, f. 288-289.
- ⁸ Dennush Shala, Këngë popullore historike, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA, Prishtinë, 1973, kënga nr. 413, f. 4000-401.
- ⁹ Snih Kahreman Ulqini, Zë i ri në enciklopedinë shqiptare (Punim i cituar në fusnotës nr. 3; Prof. Filip Fishta, Françeskani Lovro Mihaçeviq-i e vepra e tij "Nëpër Shqipni", "Hylli i dritës", Shkodër, Dhetuer 1940, XIX, Vjeti XVI, nr. 12, f. 560-564)

Mag. Ismail Doda